



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE
INDUSTRIË**

Nr. 2645/1 prot.

Tiranë, më 04.03 .2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.597/1, datë 01.01.2011.

SHOQËRISË “SALILLARI” SH.P.K

**Rruga e Vjetër , Vore - Marikaj, Km 1, Godina katër katëshe, Kati i tretë,
Nr.5, Vorë, Tiranë**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri” , Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Salillari” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr. 597/1, datë 01.11.2011, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Maklaresh”, Krujë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.1668/1 prot, datë 28.02.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 2603 prot., datë 28.02.2019 dhe nr. prot. 1833, datë 01.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 2645 prot., datë 01.03.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të nr. 597/1, datë 01.11.2011, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Maklaresh”, Krujë, për arsye se:

- **Nuk ka zbatuar projektin tekniko – ekonomik të miratuar për shesh depozitim të sterileve që krijohen nga aktiviteti mineral.**

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “e”, të pikës 1, të nenit 47. (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48. të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr. 597/1, datë 01.11.2011, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Maklaresh”, Krujë, që shoqëria juaj zotëron.**

Duhet të paguani si difference rehabilitimi shumën 2336937.5 lekë, pasi nga 3263002.5 lekë që duhet të kishit paguar sipas sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi, keni paguar 926065 lekë.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr. 597/I, datë 01.11.2011, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

